



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1949 prot.

Shkodër, më 31.01. 2025

**VENDIM  
Nr. 5 datë 30.01.2025**

**“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË BASHKËFINANCIMIT NË ZBATIM TË FONDEVE  
TË PLANIFIKUARA PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2025,  
PËR REALIZIMIN E NJË KATI SHITESË NË OBJEKTIN: BANESA SOCIALE ME  
QIRA (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS VETERINARE), I PËRSHTATUR PËR  
STREHIM SOCIAL”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.01.2025, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit Nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”; VKM-së Nr. 458, datë 03.07.2019 “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore”; VKM-së Nr. 579, datë 22.07.2020 “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët e përkohshme, të kriterëve dhe procedurave”; VKM-së Nr.405 datë 01.06.2016, Strategjia e Strehimit Social 2016 – 2025; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 33 datë 26.08.2020 “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”, Udhëzimit nr. 31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, VKB-së Nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025 – 2027 të Bashkisë Shkodër”,shkresës Nr.15900 Prot., datë 18.12.2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025” dhe sipas dokumentacionit të përgatitur nga administratës së Bashkisë Shkodër,

Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

## VENDOSI:

1. Miratimin në parim të bashkëfinancimit për realizimin e një kati shtesë në objektin Banesa Sociale me Qira (ish-Konvikti i shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social.

2. Përqindja e bashkëfinancimit do të jetë 30% të vlerës sipas preventivit total të punimeve me vlerë 56,563,064 lekë, ku:

- Bashkia Shkodër angazhohet të bashkëfinancojë projektin në masën 30 % në vlerë 16,968,919 lekë të preventivit total.
- Buxheti i Shtetit bashkëfinancon projektin në masën 70 % në vlerë 39,594,145 lekë të preventivit total.

3. Burimi financimit do të jetë fisha buxhetore P.AG141.Q6.O1.A2 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II), Programi AG141 Përkujdesi Social.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me	38	vota
Vota Pro	38	
Vota Kundër	0	
Vota Abstenim	0	
Zbardhur me datë	31.01.2025	

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**



Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)